



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.36, datë 13/12/2023

PËR

**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES  
NR.SERIE 0016, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.15, DATË  
12.07.2018 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR,  
SUBJEKTIT “MESSER ALBAGAZ” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

**V E N D O S I:**

1. Saktësimin e koordinatave të lejes Nr.Serie 0016, miratuar me Vendimin Nr.15, datë 12.07.2018 të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit me koordinata do të saktësohen:

Nga: X=4396482; Y=4580173; Z= 64m.m.n.d (ALBANIAN 1986/GK4)

Në: X=4396499; Y=4580223; Z=84m.m.n.d (ALBANIAN 1986/GK4)

Në : X=480058.9; Y=4579379.2; Z= 84 m.m.n.d (KRGJSH)

- Sasia e ujit që jepet në përdorim:  $Q = 0.25$  l/s
  - Prurja mesatare :  $Q_{mes} = 12.9$  l/s
  - Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Gropë septike, KUZ
2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes Nr.Serie 0016, miratuar me Vendimin Nr.15, datë 12.07.2018 të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen, “Leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë teknologjik (Importim dhe përpunim gazesh)”, sipas koordinatave të mësipërme të saktësuara me vendodhje, Kashar, Bashkia Tiranë.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU ISHËM**

**EMILJAN JANI**

